



Shtëpia Botuese LUARASI

Rr. Eqrem Çabej 144

Prishtinë, 10000

botimet@shbluarasi.org

www.luarasi.org

KOMENTE

lidhur me projektligjin për tekstet shkollore, i datës 05.05.2022

PROJEKTLIGJI I MASHTI-T PËR TEKSTE SHKOLLORE DEGRADON CILËSINË E TYRE

1. **Projektligji eliminon konkurrencën në dobi të krijimit të monopolit shtetëror mbi tekstet shkollore.** Duke eliminuar shtëpitë botuese si pronare të drejtave autoriale dhe duke marrë përsipër të gjitha segmentet e bërjes së teksteve shkollore, MASHTI zhduk konkurrencën, përkatësisht **shtetëzon** procesin e bërjes së librave – krijon monopol. Projektligji parasheh të drejtën e autorëve për aplikim në konkursin për tekstet shkollore me dorëshkrimet e tyre, mirëpo kjo “konkurrencë” është e pamjaftueshme për ngritjen e cilësisë së teksteve shkollore. Është e pamjaftueshme për dy arsye: e para, pronare e të drejtave autoriale për të gjitha tekstet shkollore është MASHTI; e dyta, autorët si individë, duke mos qenë operatorë ekonomikë, nuk mund të hyjnë në një konkurrencë të mirëfilltë, e cila do të ishte garantuese e një cilësie në rritje e teksteve shkollore. Pra, përfundimisht, kufizon numrin e opsioneve për përzgjedhje. Në vend se krahas shtëpive botuese t’ua hapte mundësinë për konkurrim edhe autorëve, projektligji i zëvendëson shtëpitë botuese me autorë duke zvogëluar fuqinë konkurruese;
2. **Projektligji degradon rëndë cilësinë e teksteve shkollore:**
 - 2.1. Fryma e këtij projektligji do të çojë në zvogëlimin e numrit të autorëve të interesuar për të marrë pjesë në konkurs;
 - 2.2. **Projektligji demotivon autorët.** Për dallim nga shtëpia botuese, autori individual mund të aplikojë me një, eventualisht dy tekste shkollore, kompensimi financiar për të cilat (edhe ashtu modest dhe dekurajues në krahasim me pozitën e tyre aktuale), është shumë i pasigurt, sepse varet nga aprovimi ose mosaprovimi i tyre. **Në këtë situatë, edhe ata që vendosin të aplikojnë, do të kursejnë në kohën e tyre të angazhimit intelektual për përgatitjen e tekstit për aplikim, në dëm të cilësisë së këtij të fundit.** Për dallim nga kjo, raporti aktual autor-shtëpi botuese është shumë më i favorshëm dhe motivues për ta;
 - 2.3. **Projektligji zhdukë iniciativat kreative për modernizim të teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore,** sepse këtë nuk mund ta bëjnë autorët si individë, qoftë për shkak të

mungesës së infrastrukturës, qoftë për shkak të kostos së lartë. Kurse, shtëpitë botuese si operatorë ekonomikë, të nxitura nga konkurrenca, janë shumë më të motivuara që t'i avancojnë tekstet shkollore dhe mjetet mësimore në mënyrë të vazhdueshme, madje edhe përtej kërkesave që mund të ketë MASHTI;

2.4. Projektligji dëmton në aspektin estetik dhe atë të saktësisë së librit (dy elemente të rëndësishme të cilësisë së një libri). Kjo ndodhë për shkak se nxjerr nga loja një armatë dizajnesish profesionistë që deri më sot kanë ofruar shërbimet e përgatitjes së materialeve për aplikim, duke e përqendruar tërë barrën te një ofrues i tyre (institucioni shtetëror). Kjo e dëmton rëndë cilësinë e botimeve dhe atë jo vetëm në aspektin estetik, i cili po ashtu është shumë i rëndësishëm në aspektin psikologjik për nxënësit (një dizajn i dobët e joatraktiv i demotivon ata dhe ua humbë dëshirën për të lexuar).

Në anën tjetër, duke u nisur nga përvoja, e dimë që pjesa e dizajnit të një libri shkollor (me ilustrime, ekuacione, formula etj.) është shumë e komplikuar dhe për t'i shmangur gabimet e dizajnesve (të pafamiljarizuar me materien) kërkon kujdes të veçantë e komunikim të vazhdueshëm midis tyre dhe autorëve. Pra, për shkak të kompleksitetit të tij, ky shërbim kërkon dizajnesë të shkathtë e me përvojë. Po ashtu, komunikimi në çdo kohë, për çdo detaj të librit që bëhet me një dizajnes të operatorit privat, e që është i domosdoshëm për cilësinë e librit, nuk mund të bëhet kurrë me atë që punon për një institucion shtetëror. Në fund, duke qenë se autori nuk mund ta përzgjedhë dizajnesin e, rrjedhimisht, të kërkojë llogari nga ai, siç ndodhë sot, dizajnesi, për motive të ndryshme të ulëta mund ta dëmtojë ndonjërin nga autorët;

3. Projektligji, përveç nxënësve, dëmton edhe tërë shoqërinë, në përgjithësi. Ai ndikon në stagnimin apo uljen e lexueshmërisë në shoqëri. Kjo për shkak të dobësimit të fuqisë së shtëpive botuese apo edhe eliminimit të tërësishëm të tyre, të cilat me anë të produkteve të reja dhe aktiviteteve të ndryshme promovuese ndikojnë në rritjen e shkallës së lexueshmërisë.

Përfundimisht, ne konsiderojmë se projektligji i propozuar është shumë i dëmshëm dhe ky dëm është i shumanshëm. Ky projektligj dëshmon se, fatkeqësisht, nuk është arritur të identifikohet origjina e dy defekteve të mëdha në procesin e bërjes së teksteve shkollore: mungesës së cilësisë dhe korrupsionit! Pra, kush është përgjegjës për mungesën e cilësisë dhe cilat hallka të procesit janë më të ndjeshme ndaj korrupsionit. E tërë kjo bënë që ky projektligj të jetë në kundërshtim me synimin tonë të përbashkët – rritjen e cilësisë së teksteve shkollore.

Propozim

Cilësia e teksteve shkollore mund të arrihet lehtë me anë të amandamentimit të ligjit aktual për tekstet shkollore. Për këtë ne propozojmë këto ndryshime (disa prej të cilave i përmban edhe projektligji që është në fazën e konsultimit publik):

- 1. Certifikimi i recensentëve,** përkatësisht dizajnimi i një programi nga ana e MASHTI-t për ngritjen e kapaciteteve të recensentëve;
- 2. Forcimi i kriterëve të vlerësimit;**
- 3. Përveç shtëpive botuese, në konkursin për tekste shkollore të lejohen të aplikojnë edhe autorët. Pas vlerësimit eventual pozitiv të dorëshkrimeve të tyre, ata drejtohen te shtëpitë**

botuese për botim. Ky ndryshim i fuqizon autorët (sepse, si fitues, janë në pozicion të favorshëm në raport me shtëpitë botuese);

4. **Konkursi për tekstet shkollore të jetë periodik, apo të jetë i hapur gjatë tërë kohës.** Ky ndryshim ndihmon shumë në cilësinë e teksteve, sepse shtëpitë botuese janë përherë në konkurrencë;
5. **MASHTI, me anë të konkursit për tekstet shkollore, të rritë kërkesat për modernizimin e tyre.** Për shembull, në mënyrë graduale mund të fillohet me procesin e digjitalizimit të teksteve shkollore. Digjitalizimin e teksteve shkollore mund ta bëjnë vetëm shtëpitë botuese, si operatorë ekonomikë që janë.

Prishtinë

27.06.2022